



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

VENDIM
Nr. 07 Datë 23.10.2020

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT Z. FLAMUR LUTFI CENA NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË DIBËR, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

VËREN

Me shkresën nr. 2300 prot., datë 02.07.2020, këshilli i bashkisë Dibër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, për arsye të dorëheqjes nga mandati i këshilltarit z. Erger Dylber Kosiqi.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Dibër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 16, z. Flamur Lutfi Cena.

Me shkresën nr. 1353 prot., datë 14.07.2020 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Dibër, z. Flamur Lutfi Cena, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.



Nr. 07 i vendimit

Data 23.10.2020 e vendimit

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit z. Flamur Lutfi Cena nga lista shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Dibër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0038 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar z. Flamur Lutfi Cena, në këshillin e bashkisë Dibër, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 1398 prot., datë 22.07.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1397 prot., datë 22.07.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Flamur Lutfi Cena, në Këshillin e Bashkisë Dibër, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 5413/1 prot., datë 12.10.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes civile për kandidatin për anëtar z. Flamur Lutfi Cena, në këshillin e bashkisë Dibër, nga ku rezulton se nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 7561/1 prot., datë 27.07.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Flamur Lutfi Cena, në këshillin e bashkisë Dibër, i cili rezulton me status i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar z. Flamur Lutfi Cena, në këshillin e bashkisë Dibër, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Dibër.



PËR KËTO ARSYE:


Bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSA:

1. Z. Flamur Lutfi Cena, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Dibër, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Dibër, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore z. Flamur Lutfi Cena, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONER

Ilirjan CELIBASHI



Nr. 07 i vendimit

Data 23.10.2020 e vendimit

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit z. Flamur Lutfi Cena nga lista shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Dibër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.